

Miratim për të marrë pjesë në Hulumtim

Juve ju kërkohet të merrni pjesë në një studim hulumtues. Para se të bini dakord duhet t'ju sigurohet një përmbledhje e studimit të hulumtimit. Kjo përmbledhje duhet të përmbajë informacionin kyç për t'ju ndihmuar të kuptoni arsyet pse mund të dëshironi apo të mos dëshironi të merrni pjesë në studim.

Para se të bini dakord, hulumtuesi duhet t'ju tregojë rreth:

- (i) qëllimeve, procedurave dhe kohëzgjatjes së hulumtimit;
- (ii) çdo procedure e cila është eksperimentale;
- (iii) çdo rreziku, pakënaqësie dhe përfitimi të arsyeshëm dhe të parashikueshëm;
- (iv) çdo procedure apo trajtimi alternativ të mundshëm;
- (v) mënyrën si do të ruhet konfidencialiteti; dhe
- (vi) kë të kontaktoni për pyetje, ankesa apo lëndime.

Atje ku është e zbatueshme, hulumtuesi duhet që gjithashtu t'ju tregojë edhe për:

- (i) çdo kompensim të disponueshëm apo trajtim mjekësor nëse ndodh ndonjë lëndim;
- (ii) mundësinë e rreziqeve të paparashikuara;
- (iii) rrethanat kur hulumtuesi mund ta ndërpresë pjesëmarrjen tuaj;
- (iv) çdo kosto të shtuar për ju;
- (v) çfarë ndodh nëse vendosni të ndërprisni pjesëmarrjen tuaj;
- (vi) kur do t'ju tregohet për zbulimet e reja të cilat mund të ndikojnë gatishmërinë tuaj për të marrë pjesë;
- (vii) sa njerëz do të marrin pjesë në studim; dhe
- (viii) faktin që keni nevojë të autorizoni përdorimin e informacionit tuaj mjekësor për studim.

Pjesëmarrja juaj në këtë hulumtim është vullnetare, dhe nuk do të penalizoheni apo të humbisni përfitimet nëse refuzoni të merrni pjesë apo të ndërprisni pjesëmarrjen tuaj. Firmosja e këtij dokumenti do të thotë që studimi hulumtues, duke përfshirë dhe informacionin e mësipërm, ju është përshkruar gojarisht dhe që vullnetarisht bini dakord të merrni pjesë në të. Nëse bini dakord të merrni pjesë, duhet t'ju jepet një kopje e firmosur e këtij dokumenti dhe një përmbledhje e shkruar e hulumtimit në Anglisht.

Keni pyetje?

Nëse keni pyetje, ankesa, lëndime apo shqetësime në lidhje me këtë studim, mund të kontaktoni hulumtuesin duke përdorur numrat e telefonit në përmbledhjen me shkrim të studimit. Nëse keni pyetje në lidhje me të drejtat tuaja si pjesëmarrës në këtë hulumtim, ose po të keni pyetje, ankesa apo shqetësime të cilat nuk ndiheni se mund t'i diskutoni me hulumtuesin, ju lutemi kontaktoni Zyrën e Bordit të Rishikimit Institucional [Institutional Review Board Office] duke përdorur numrin e telefonit ose adresën e email-it në përmbledhjen e shkruar të studimit.

Emri i Pjesëmarrësit

Firma e Pjesëmarrësit

Data

Konfirmoj që isha i pranishëm si interpretues për kohëzgjatjen e procesit të miratimit për këtë studim hulumtues. Konfirmoj që jam i/e kualifikuar dhe kam aftësitë e nevojshme që të siguroj interpretimin mes gjuhës së pjesëmarrësit dhe gjuhës Angleze. Duke firmosur këtë formular, konfirmoj që me njohurinë time më të mirë kam siguruar një interpretim të plotë dhe tërësor të bisedës mes hulumtuesit që kërkon miratim dhe pjesëmarrësit.

Emri i Interpretuesit

Firma e Interpretuesit

Data